



ZBATIMI NË PRAKTIKË TË LIGJEVE PËR NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK DHE E DREJTA PËR INFORMIM NË NIVEL VENDOR

RAPORT MONITORIMI

2024



**ZBATIMIT NË PRAKTIKË I LIGJEVE PËR
NJOFTIMIN DHE KONSULTIMIN PUBLIK
DHE
E DREJTA PËR INFORMIM
NË NIVEL VENDOR**

RAPORT MONITORIMI

Tiranë, shkurt 2024



Ky material është përgatitur nga Qendra Europiane dhe Fondacioni Konrad Adenauer në kuadër të projektit “Pjesëmarrja e qytetarëve në qeverisjen vendore”

Përgatitën botimin:

MSc. Ina Xhepa, MSc. Rildo Ngjela

Përmbajtja e këtij materiali, opinionet, dhe vlerësimet e shprehura në të, janë përgjegjësi e vetme e autorëve dhe jo domosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Fondacionit Konrad Adenauer.

Design & Layout: Elzana Agolli

Ky botim u realizua me mbështetjen e Fondacionit Konrad Adenauer Stiftung në Tiranë



Përmbajtja

QËLLIMI I RAPORTIT	5
METODOLOGJIA.....	9
I. TË KUPTOJMË PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK DHE TË DREJTËN E PUBLIKUT PËR TË MARRË INFORMACION	11
1.1 Njoftimi dhe Konsultimi Publik.....	11
1.2 E drejta për informim	15
II. TESTIMI NË PRAKTIKË I NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK DHE TË DREJTËS PËR INFORMIM.....	19
2.1 Informacionet e ofruara nga vetë Bashkitë.....	19
2.1 Testimi në Praktikë	30
GJETJET KRYESORE TË MONITORIMIT DHE REKOMANDIME	35
SHTOJCA I.....	41
BIBLIOGRAFI.....	46

Qëllimi i raportit

Tranzicioni i Shqipërisë drejt një sistemi demokratik të konsoliduar nuk ka qenë i lehtë. Për të ndërtuar një demokraci pluraliste dhe garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës janë bërë përpjekje afatgjata dhe komplekse. Problemet me të cilat po përballlet Shqipëria vitet e fundit kanë sjellë pengesa në konsolidimin e vlerave evropiane. Një mangësi e veçantë vërehet në zbatimin e rekomandimeve, të cilat kanë ardhur nga organizatat ndërkombëtare, veçanërisht ato rekomandime që lidhen me inkurajimin e qytetarëve, e veçanërisht të rinjve, për pjesëmarrje aktive në proceset vendimmarrëse. Nga njëra anë, shkak kryesor i kësaj mangësie buron nga pabarazia gjinore deri tek mungesa e kapaciteteve dhe programeve të institucioneve arsimore për t'i ofruar brezit të ri informacion të saktë për proceset e demokratizimit. Nga ana tjetër, vetë brezi i ri shfaq një qëndrim pasiv, kryesisht për shkak të mungesës së njohurive dhe informacionit, të cilat mëshojnë në realizimin e të drejtave të tyre me fokus të veçantë, si dhe të drejtës së tyre si qytetarë për të marrë informacion për vendimet dhe shpenzimet publike.

Në vitin 2014 Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar dy ligje të rëndësishme që garantojnë pjesëmarrjen e publikur

në vendimmarrje: ligji “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe ligji “Për të drejtën e informimit”. Sot dhjetë vite pas hyrjes në fuqi të këtyre akteve, efekteve të ardhura nga ndarja administrativo-territoriale, drejtimin e pjesës më të madhe të bashkive në rang vendi nga e njëjta forcë politike, si dhe pjesëmarrjes së ulët të të rinjve në zgjedhjet e fundit lokale, lind nevoja e monitorimit në praktikë të zbatimit të këtyre ligjeve.

Përmes këtij raporti monitorimi është kryer një matje në praktikë e progresit të zbatimit të të drejtës së qytetarëve për të marrë pjesë në konsultimin publik dhe për të marrë informacion mbi dokumentet zyrtare në nivel vendor. Kështu, synimi i iniciativës së përbashkët mes Qendrës Europiane dhe Fondacionit Konrad Adenauer është përmirësimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Ne jemi munduar të japim një pasqyrë të situatës aktuale të institucioneve vendore, por edhe shkallës së ndërgjegjësimit të publikut për të ushtruar në praktikë të drejtat e garantuara nga ligji.

Metodologjia

Përsa i takon metodologjisë, hartimi i këtij raporti u realizua përmes përdorimit të metodës cilësore duke përshkruar dhe analizuar materialet. Së pari, puna u ndal në hulumtimin dhe identifikimin e materialeve përkatëse burimore, legjislationit kombëtar dhe standardeve ndërkombëtare në lidhje me qeverisjen e hapur, duke mbajtur në fokus të veçantë udhëzimet e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD)¹, gjetjet e raporteve të progresit të Komisionit Evropian, si dhe Kodin e Praktikave më të Mira për Pjesëmarrjen e Qytetarëve në Proceset Vendimmarrëse². Analiza e këtyre materialeve u ndërthur më pas me testimin e respektimit të detyrimeve të sjella nga ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” dhe ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë e për zbatim të tyre, nga vetë bashkitë, përmes monitorimit të faqeve zyrtare të internetit të 61 njësive të qeverisjes vendore në Shqipëri, regjistrin elektronik të qeverisjes vendore, si dhe testimin në praktikë të funksionimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik.

¹ <https://www.oecd-ilibrary.org/deliver/0fdc1657-en.pdf?itemId=/content/publication/0fdc1657-en&mimeType=pdf>

² <https://rm.coe.int/code-of-good-practice-civil-participation-revised-301019-en/168098b0e2>

Hartimi i këtij raporti nisi me dërgimin e një kërkesë të standardizuar për informacion, e cila ju dërgua në të njëjtën kohë të 61 Bashkive të Shqipërisë, duke kërkuar informacion dhe dokumente mbi procesin konsultues të një akti të një rëndësie të veçantë sikurse është Buxheti i vitit korrent dhe Programi Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 për këto njësi të qeverisjes vendore.

Sikurse u përmend më lart, testimi i transparencës së bashkive në praktikë u shoqërua me monitorimin e transparencës së publikuar nga vetë bashkitë duke përfshirë këtu:

- ✓ planin vjetor të miratimit të projekt-akteve;
- ✓ programin e transparencës për periudhën e monitorimit [2023];
- ✓ të dhëna për koordinatorin përgjegjës për konsultimin publik dhe për atë të së drejtës për informim;
- ✓ publikimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve;
- ✓ publikimin e proces-verbaleve të mbledhjeve;
- ✓ të dhëna mbi buxhetin dhe shpenzimet;
- ✓ lehtësia në përdorim e faqeve të internetit; si dhe
- ✓ të dhëna të tjera relevante.

Gjithësesi, hartimi i këtij raporti monitorimi ka ndeshur në kufizime metodologjike për një sërë arsyesh.

Së pari, testimi në praktikë i transparencës së njërive të qeverisjes vendore është bërë vetëm për ato njësi, të cilat iu përgjigjën kërkesës për informacion dërguar nga Qendra Europiane dhe Fondacioni Konrad Adenauer, duke mos përfshirë këtu gati gjysmën e bashkive të vendit.

Së dyti, një element tjetër kufizues ka qenë mungesa e të dhënave sasiore dhe për rastet kur informacioni

është ofruar, këto të dhëna vetëm në shumë pak raste kanë qenë të sakta.

Së treti, monitorimi nuk përfshin perceptimin ose qasjen e qytetarëve në lidhje me transparencën e bashkive ku ata jetojnë.

Gjithësesi, besojmë se ky raport paraqet një panoramë të funksionimit në praktikë të ligjeve për njoftimin dhe konsultimin publik, si dhe ligjit për të drejtën e informimi 10 vjet pas miratimit të tyre.

1

Të kuptojmë procesin e konsultimit publik dhe të drejtën e publikut për të marrë informacion

1.1 Njoftimi dhe Konsultimi Publik

Konsultimi publik është një ndër mjetet kryesore të cilat përmirësojnë transparencën, efikasitetin dhe efektivitetin në vendimmarrje.³ Ky proces përfshin drejtpërdrejt qytetarët në miratimin e projektligjeve, projekt-dokumente strategjike kombëtare dhe vendore, si dhe politikave të tjera me interes publik.⁴ Ekzistojnë një numër i kufizuar dokumentesh të cilat përjashtohen nga ky proces të cilat lidhen me sigurinë kombëtare, marrëdhëniet ndërkombëtare dypalëshe, aktet individuale, aktet normative me fuqinë e ligjit, si dhe akte të tjera të lidhura me emergjencat.⁵

Parimet kryesore⁶ mbi të cilat duhet të mbështetet procesi i njoftimit dhe konsultimit publik janë:

- a) **Transparenca** - e cila nënkupton një proces publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse. Njoftimin dhe

³ <https://www.oecd.org/mena/governance/36785341.pdf>

⁴ Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, neni 1.

⁵ Ibid., neni 4.

⁶ Ibid., neni 5.

sigurimin e aksesit në kohë për të gjithë dokumentet, që do t`i nënshtrohen procesit të konsultimit. Gjithashtu, ky parim përfshin dhe marrjen në shqyrtim të rekomandimeve të paraqitura, publikimin e tyre në rastet kur janë pranuar ose refuzuar duke i argumentuar.⁷

- b) **Efektshmëria** – duhet të karakterizojë procesin e konsultimit sa i takon vendimmarrjes së institucionit publik. Kjo nënkupton se gjithë ky proces duhet të ketë një vlerë të shtuar nga pikëpamja e përmbajtjes për përmirësimin e aktit, por sigurisht dhe nga pikëpamja e kohës kur ndodh, me qëllim analizimin dhe reflektimin e sugjerimeve/komenteve.⁸
- c) **Përgjegjësia e organeve** - pjesëmarrja e aktorëve të parashikuar në ligj në procesin konsultues duhet të prodhojë rezultate të cilat përmirësojnë aktin nga versioni fillestar. Organet publike kanë përgjegjësi të dokumentojnë dhe publikojnë të gjithë procesin e konsultimit⁹.

Me qëllim vendosjen në praktikë të parimeve të sipërpërmendura, njoftimi dhe konsultimi publik përfshin **tre elemente** kryesore:

- a) **Njoftimin** - komunikimin e institucioneve publike në nivel qendror dhe vendor me qytetarët, si pikë kyçe për funksionimin e shtetit të së drejtës. Ky komunikim,¹⁰ i cili është detyrë e institucioneve publike, kryhet në mënyrë zyrtare përmes regjistrimit elektronik, publikimit në programin e transparencës së institucionit, si dhe njoftimit përmes postës

⁷ <https://rm.coe.int/code-of-good-practice-civil-participation-revised-301019-en/168098b0e2> f. 7-8.

⁸ Ibid.

⁹ Ibid.

¹⁰ Ibid., neni 6(1).

TË KUPTOJMË PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK DHETË DREJTËN E PUBLIKUT PËR TË MARRË INFORMACION

elektronike, faqeve zyrtare dhe metoda të tjera p.sh. afishime në institucione.

- b) **Konsultimin** - i cili nënkupton mbledhjen e sugjerimeve të qytetarëve dhe grupeve të tjera të interesit në lidhje me projekt-aktin që do të miratohet. Ky proces mund të formalizohet në formë shkresore duke ia drejtuar institucionit, por edhe në formë verbale gjatë organizimit të takimeve publike.¹¹ Kjo hallkë e procesit lidhet në mënyrë substanciale me mbledhjen e informacionit konkret për të hartuar një draft më të konsoliduar të projekt-dokumentit, që diskutohet.¹²
- c) **Pjesëmarrja** – konsultimi i dokumenteve zyrtare nuk do të kishte vlerë nëse në këtë proces nuk marrin pjesë realisht qytetarët dhe ai kryhet vetëm *pro forma*. Në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi në Shqipëri gjatë këtij procesi mund të marrin pjesë: organe të tjera publike, qytetarë dhe grupe interesi, si dhe persona fizikë e juridik të huaj me vendqëndrim të përhershëm dhe të regjistruar në Shqipëri. Ndërkohë, të huaj të tjerë mund të marrin pjesë vetëm në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare ku Shqipëria është pjesë.¹³

Pra, përpos respektimit të aspekteve procedurale të kryerjes së konsultimit publik, të gjitha palët e interesuar në konsultimin e një projekt-dokumenti duhet të pajisen **në kohë** me informacionin e nevojshëm, me qëllim që të kontribuojnë efektivisht në përmirësimin e projekt-aktit. Dërgimi i informacionit [shpesh herë voluminoz] dhe kërkesa për paraqitjen e komenteve/rekomandimeve ose

¹¹ Ibid., neni 6(2).

¹² <https://www.oecd.org/mena/governance/36785341.pdf>, f.1.

¹³ Ibid., neni 8.

për pjesëmarrje në takime konsultuese për një kohë shumë të shkurtër nuk reflekton qëllimin e ligjit dhe as parimet e konsultimit publik.¹⁴

Sipas ligjit, **afati**¹⁵ për dorëzimin e komenteve dhe rekomandimeve nga ana e qytetarëve dhe grupeve të interesit është:

- ✓ Brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit paraprak;
- ✓ Brenda 20 ditëve pune nga data e njoftimit për procesin e njoftimit e të konsultimit publik.

Përrjashtime nga këto afate të zakonshme bëhen vetëm në rastin e dokumenteve të një rëndësie të veçantë, ku afati mund të zgjatet deri në 40 ditë pune.

Çdo institucion publik ka detyrim të caktojë në rolin e **koordinatorit**¹⁶ një person përgjegjës për njoftimin dhe konsultimin publik, i cili ka detyrë garantimin e zbatimit të të drejtave që burojnë nga ligji për këtë proces. Të dhënat e koordinatorit duhet të jenë publike në faqet zyrtare të institucioneve.

Institucionet publike detyrohen të publikojnë dhe përditësojnë në kohë reale të gjithë projekt-aktet e shpallura për konsultim në regjistrin përkatës elektronik, i cili për qeverisjen qendrore është **[konsultimipublik.gov.al](https://www.konsultimipublik.gov.al)** dhe për qeverisjen vendore është **[konsultimivendor.al](https://www.konsultimivendor.al)**.

Në rastet kur qytetarët, ose grupet e interesit kanë ankesë për mos respektim të parashikime ligjore të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, ata kanë

¹⁴ Ibid., neni 14.

¹⁵ Ibid., neni 15.

¹⁶ Ibid., neni 10.

të **drejtë të ankohen brenda 30 ditëve**¹⁷ nga data e miratimit të aktit pranë:

- ✓ Titullarit të institucionit publik përgjegjës;
- ✓ Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Sipas rastit ankimi ndiqet nga titullari ose Komisioneri, i cili mund të gjobisë titullarin e institucionit.

Megjithatë, ankimi në të dy rastet **nuk sjell pasoja të drejtpërdrejta** në lidhje me prodhimin e efekteve juridike të aktit të miratuar pa u konsultuar sipas parashikimit ligjor.

1.2 E drejta për informim

Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” garanton rregulla konkrete për mbrojtjen dhe shndërrimin e kësaj të drejte në një të drejtë reale dhe lehtësisht të zbatueshme në praktikë.

Qëllimi parësor i këtij ligji është dhënia maksimale e informacionit në praktikë. Nëpërmjet tij synohet, që autoritetet të tregojnë përpara qytetarëve më shumë llogaridhënie, të krijojnë më shumë besim dhe të vlerësojnë parimet demokratike.

Sikurse e përmendëm më lart aksesi në informacion është një instrument për të parandaluar punën e dobët, shkeljet, abuzimet me pushtetin dhe korrupsionin. Transparenca administrative njihet si një e drejtë themelore e individit dhe një komponent kyç i qeverisjes demokratike.

¹⁷ Ibid., neni 21.

Sipas ligjit, **informacion publik**¹⁸ është çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik, pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga autoriteti publik. Kjo do të thotë se autoriteti publik është i detyruar të japë informacion dhe dokumentacion të prodhuar nga vetë autoriteti, nga autoritete të tjera publike, ose nga subjekte private, por që disponohen nga autoriteti publik, pavarësisht nga forma e ruajtjes.

Subjektet¹⁹ e detyruara për të dhënë informacion janë:

- ✓ Organet administrative të parashikuara në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative;
- ✓ Organet ligjvënëse;
- ✓ Organet gjyqësore dhe ato të prokurorisë të çdo niveli;
- ✓ Organet e njësisë të qeverisjes vendore të çdo niveli;
- ✓ Organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj;
- ✓ Shoqëritë tregtare, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve dhe ku ushtrohen funksione publike;
- ✓ Çdo person fizik ose juridik, të cilit i është dhënë me ligj, akt nënligjor, ose çdo lloj forme tjetër, e drejta e ushtrimit të funksioneve publike.

Ligji parashikon **dy mënyra për marrjen e informacionit**²⁰:

- ✓ Transparenca e garantuar nga vetë institucioni - një sërë kategorish të dokumentave që bëhen publike pa kërkesë paraprake. Pikërisht kjo bëhet në përputhje me programin e miratuar të transparencës;

¹⁸ Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, neni 2.

¹⁹ Ibid., neni 1.

²⁰ Ibid., nenet 7 dhe 11.

TË KUPTOJMË PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK DHETË DREJTËN E PUBLIKUT PËR TË MARRË INFORMACION

- ✓ Vënia në lëvizje nga individ – në këtë rast çdo individ ka të drejtë të dërgojë një kërkesë për informacion institucionit publik.

Afatet²¹ e kthimit përgjigje mbi kërkesën për informim, sipas ligjit, janë për sa vijon:

- jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të kërkesës, autoriteti publik duhet ta trajtojë, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur;
- jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë, kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër;
- të dyja këto afate mund të zgjaten me jo më shumë se 5 ditë pune, për një nga shkaqet e mëposhtme:
 - nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;
 - nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;
 - nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim nga nëpunësi civil brenda afateve të sipër përmendura do të konsidero het refuzim.

Megjithatë, e drejta për informim si një e drejtë themelore materiale **mund të kufizohet**²² vetëm me ligj, për një qëllim të ligjshëm dhe ky kufizim duhet të jetë i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Ligji për të drejtën e informimit përcakton qëllimet e ligjshme për të cilat kjo e drejtë mund të kufizohet.

²¹ Ibid., neni 15.

²² Ibid., neni 17.

2

Testimi në praktikë i njoftimit dhe konsultimit publik dhe të drejtës për informim


Sikurse e përmendëm në seksionin e metodologjisë, monitorimi i respektimit të parashikimeve të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, si dhe i ligjit për të drejtën për informim kaloi në dy faza. Faza e parë i takon monitorimit të informacioneve të ofruara nga vetë bashkitë në faqet e tyre zyrtare të internetit. Ndërkohë, faza e dytë përfshiu dërgimin e një kërkesë të unifikuar për informacion për të 61 bashkitë e vendit dhe analizimin e të dhënave të marra nga përgjigjet e gjeneruara për këtë kërkesë.

Theksojmë dhe një herë që metoda e përdorur për analizim dhe përshkrim të rezultateve të monitorimit është metoda cilësore. Mungesa e të dhënave të detajuara sasiore është vërejtur si kufizim metodologjik.

2.1 Informacionet e ofruara nga vetë Bashkitë

Gjatë monitorimeve të kryera në 61 bashki të vendit, rezulton se vetëm 17 prej tyre, të cilat përkthehen në 28% të rasteve, kanë publikuar planin vjetor të projekt-akteve për miratim. Ndërkohë, pjesa më e madhe e bashkive, konkretisht 19 të tilla, ose 31%, nuk e kanë të publikuar planin vjetor. Janë 10 bashki ose 16% e


Plani vjetor i projekt-akteve për miratim



Grafik 1- Publikimi i planit vjetor të projekt-akteve për miratim

tyre, të cilat nuk ofrojnë informacion lidhur me këtë dokument. Nga ana tjetër, 8 bashki ose 13%, e kanë të publikuar planin vjetor të projekt-akteve për miratim, por rezultojnë pa përditësuar. Nga ana tjetër, në 6 bashki ose 10%, ky dokument nuk aksesohet dhe për 1 bashki informacioni që gjendet është i pjesshëm.

Publikimi i raportit të transparencës së një viti më parë




Grafik 2 - Publikimi i raporteve të transparencës 2023

TESTIMI NË PRAKTIKË I NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK DHE TË DREJTËS PËR INFORMIM

Lidhur me publikimin e raporteve të transparencës 2023, nga monitorimi i kryer është evidentuar se më tepër se gjysma e këtyre institucioneve, pra 31 bashki ose 51%, nuk kanë të publikuar raportin e transparencës së një viti më parë. Ndërkohë, vetëm tek 6 bashki ose 10% e totalit mund të gjesh të publikuar raportin e vitit paraardhës. Ndërsa në 7 bashki nuk mund të gjenden raportet e transparencës së përditësuar dhe në 6 bashki ky dokument nuk është i aksesueshëm. Gjithashtu, rezulton se në 11 prej tyre nuk ofrohet asnjë informacion, lidhur me raportin e transparencës, ku faqja është bosh ose rubrika në fjalë nuk hapet.

Lehtësi në aksesueshmërinë e faqes online të Bashkisë




Grafik 3- Aksesueshmëria e faqeve online të bashkive

Në vijim të monitorimit, jemi përpjekur të kuptojmë lehtësinë e aksesueshmërisë në faqet zyrtare publike të bashkive. Pas vëzhgimit të bërë rezulton se 43 prej bashkive ose 70% e totalit janë lehtësisht të aksesueshme dhe vetëm 6 ose 10% e tyre nuk mund të aksesohen. Numri i faqeve që aksesohen me vështirësi është 9. Ndërkohë, vetëm 1 nga bashkitë

nuk ofron informacion për konsultimet publike dhe për 2 bashki të tjera faqja është e bosh.


Informacione mbi konsultimet publike të ardhshme ose të kryera



Grafik 4 - Informacione mbi konsultimet publike

Përsa i përket publikimit të informacioneve mbi konsultimet publik, është evidentuar se 22 prej bashkive ose 36%, kanë të publikuar informacione mbi konsultimet publike të kryera ose ato që do të zhvillohen në të ardhmen. Për 12 bashki nuk ka asnjë informacion të publikuar për këto çështje, ndërsa 6 prej tyre nuk mund të aksesohen. Nga ana tjetër, 8 bashki nuk ofrojnë informacion në këto rubrika, ku faqet rezultojnë të jenë bosh dhe në disa raste nuk hapen fare. Gjithashtu, 13 prej këtyre institucioneve ose 21% e totalit, nuk ofrojnë informacion të përditësuar.

Publikimi i afateve për konsultim dhe rekomandime/komente të ardhura




Grafik 5 - Publikim i afateve konkrete të konsultimit

Lidhur me afatet konkrete të konsultimit, rezultojnë se në 42 bashki ose për 69% të tyre publikimi i afateve për konsultim dhe rekomandime të ardhurave nuk janë të publikuara dhe vetëm 4 institucione ose për vetëm 7% këto afate janë publikuar. Natyrisht që në këto raste përdoren afatet ligjore, por jo të gjithë qytetarët mund të kenë dijeni për to.

Ndërkohë, 8 bashki nuk ofrojnë asnjë informacion për këtë çështje (faqet rezultojnë të boshatisura ose nuk mund të hapen). Në 6 bashki të vendit ky informacion nuk është i aksesueshëm, ndërsa në 1 prej tyre, në vend të afateve dhe rekomandimeve janë të publikuara kontaktet ku mund të dërgohen këto rekomandime.


Struktura organizative



Grafik 6 – Publikimi i strukturës organizative

Lidhur me grafikun e strukturës organizative 46% e bashkive ose 28 prej këtyre institucione vendore tyre nuk e kanë publikuar strukturën organizative. Në 24 faqe zyrtare mund të gjesh organigramën e institucionit. Ndërkohë, në 6 prej tyre materiali nuk mund të aksesohet dhe në 2 bashki të tjera kjo organigramë është e pa përditësuar. Vetëm 1 bashki nuk ofron informacion.

Jetëshkrimi i Funkionarëve të Lartë




Grafik 7 - Publikimi i Jetëshkrimeve (CV) të funksionarëve të lartë

TESTIMI NË PRAKTIKË I NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK DHE TË DREJTËS PËR INFORMIM

Përmes monitorimit të kryer rezultoi se vetëm 3 prej tyre ose 5% e totalit të bashkive kanë të publikuar jetëshkrimet (CV) e funksionarëve të lartë. Ndërkohë, në 48 bashki ose 79% e këtyre institucioneve nuk kanë publikuar jetëshkrimet e këtyre funksionarëve. Në 6 bashki këto dokumente nuk mund të aksesohen. Nga ana tjetër, në 1 bashki është e publikuar vetëm CV e kryetarit/kryetares; në 1 bashki tjetër nuk janë përditësuar të dhënat e kreut të institucionit; ndërsa në 1 bashki janë publikuar pjesërisht dhe vetëm tek 1 prej tyre rubrika është e paaksesueshme.


Lista e anëtarëve të Këshillit Bashkiak



Grafik 8 - Publikimi i listës së anëtarëve të Këshillit Bashkiak

Lidhur me publikimin e listave të anëtarëve të Këshillit Bashkiak vetëm në 42 prej bashki ose 69% këto lista gjenden të publikuara. Ndërkohë, në 10 bashki, që përbëjnë 16% të totalit, nuk ka asnjë informacion mbi anëtarët e Këshillave Bashkiak. Sakaq, në 6 bashki këto lista nuk janë të aksesueshme dhe në tre institucione listat e anëtarëve të Këshillit nuk janë të përditësuara.


Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak



Grafik 9 - Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak

Referuar grafikut 9 në lidhje me bërjen publike të vendimeve të Këshillave Bashkiakë rezulton se në 52 prej bashkive i publikojnë këto vendime. Ndërkohë, 7 prej bashkive nuk i kanë publikuar ato, dhe në 2 prej tyre nuk gjendet asnjë informacion në faqen zyrtare apo në regjistrin elektronik vendime.al.

Financat vendore




Grafik 10 - Publikimi i financave vendore

TESTIMI NË PRAKTIKË I NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK DHE TË DREJTËS PËR INFORMIM

Vetëm në faqet e 18 bashkive gjenden të dhëna të publikuara mbi buxhetin dhe shpenzimet vendore. Ndërkohë, rezulton se 22 bashki ose 36% e totalit nuk kanë publikuar asnjë informacion, lidhur me planifikimin dhe rezultatet financiare. Në 11 bashki nuk ofrohet asnjë akses për këtë informacion, ndërsa në 6 prej tyre ky dokument nuk është i aksesueshëm. Gjithashtu, në 4 bashki ose 7 % të totalit, faqet rezultojnë të boshatisura ose me rubrika që nuk mund të hapen.


Të dhëna për koordinatorin për të drejtën për informim



Grafik 11 - Të dhënat për koordinatorin për të drejtën për informim

Gjatë monitorimeve të kryera, rezulton se 50 bashki kanë publikuar të dhënat për koordinatorin për të drejtën e informimit, ndërsa në 4 prej tyre nuk janë publikuar. Ndërkohë, në 6 institucione vendore ky informacion nuk mund të aksesohet dhe vetëm në 1 bashki informacioni është i pa përditësuar. Kështu, vërejmë se pjesa dërrmuese e këtyre institucioneve janë transparente sa i takon të dhënave të koordinatorit për të drejtën e informimit.


Kontaktet për koordinatorin e të drejtës për informim



Grafik 12 - Kontaktet e koordinatorit

E njëjta linjë mbahet dhe sa i takon të koordinatorit ku 49 bashki ose 80% e totalit, kanë publikuar kontaktet e koordinatorit e të drejtës për informim. Ndërsa në 12 bashki ky informacion nuk është i publikuar (6) ose nuk është i aksesueshëm (6).


Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve



Grafik 13 - Publikim i regjistrit të kërkesave

TESTIMI NË PRAKTIKË I NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK DHE TË DREJTËS PËR INFORMIM

Përsa i përket publikimit të regjistrit të kërkesave, rezulton se 33 prej bashkive kanë të publikuar regjistrin e kërkesave për informacion dhe përgjigjeve. Ndërkohë, 7 bashki nuk e kanë të publikuar fare këtë informacion. Gjithashtu, në 15 institucione vendore ky informacion nuk është i përditësuar, kurse në 6 bashki të tjera dokumenti është i paaksesueshëm.



Grafik 14 - Publikimi i formatit të kërkesës

Sa i takon kërkesës ligjore për publikimin e formatit të kërkesës për informacion, 32 prej bashkive e kanë publikuar këtë format. Ndërkohë, 21 ose në 34% të bashkive ky format nuk është i publikuar. Nga ana tjetër, 2 prej institucioneve vendore nuk e kanë publikuar asnjë formë dhe në 6 bashki të tjera ky dokument nuk mund të aksesohet.


2.2 Testimi në Praktikë

Sikurse e përmendëm në krye të herës monitorimi i zbatimit të parashikimeve të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, si dhe të drejtën për informim u krye dhe përmes testimit praktik të 61 bashkive.

Të dhënat në vijim paraqesin rezultate përsa i përket të gjetjeve të gjeneruara nga kthimi i përgjigjeve së kërkesave për informacion dërguar nga organizatat partnere për të gjithë njësitë e qeverisjes vendore. Përmes kësaj shkrese të gjitha bashkive në rang vendi ju kërkua informacion dhe dokumente mbi procesin konsultues të përgatitjes së buxhetit për vitin korrent dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2024-2026 në nivel vendor. Vendimi për monitorimin e këtij procesi konsultues u mor për shkak të rëndësisë së veçantë që ka buxheti i shtetit dhe detyrimet për konsultim të parashikuara në ligjin specifik për buxhetin dhe udhëzimin përkatës të Ministrisë Përgjegjëse për Financat.

Vërejmë se vetëm 35 njësi të qeverisjes vendore iu përgjigjën kërkesës për informacion të dërguar nga Qendra dhe KAS, qoftë brenda afatit ligjor apo në tejkalim të tij. Ndërsa nga 26 bashki të tjera nuk patëm një përgjigje zyrtare.

Përgjigje kërkesës për informacion dhe respektimi i afatit ligjor




Grafik A – Bashkitë që i janë përgjigjur kërkesës për informacion

TESTIMI NË PRAKTIKË I NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK DHE TË DREJTËS PËR INFORMIM

Pas kërkesës për informacion, rezulton se 30 bashki ose 49% e totalit janë **përgjigjur brenda afatit ligjor** të përcaktuar, ndërsa 5 bashki janë përgjigjur në tejkalim të këtij afati. Ndërkohë, 26 bashki nuk kanë kthyer një përgjigje zyrtare sa i takon kërkesës sonë, e cila përfshinte elementë të papublikuara në faqet zyrtare të këtyre institucioneve.


Sa organizata/ grupe interesi janë njoftuar për konsultim?



Grafik B – Numri i organizatave të njoftuara për konsultim

Në kërkesën për informacion, të dërguar në secilën nga bashkitë, Qendra ndër të tjera ka kërkuar informacion për **numrin e organizatave apo grupeve të interesit të njoftuara** për konsultimin publik që është zhvilluar. Nga përgjigjet zyrtare rezulton se **28 bashki (80%), nuk i janë përgjigjur** kësaj pyetje. Ndërsa **7 bashki (20%) kanë dhënë informacion** lidhur me njoftimet që ju janë bërë organizatave apo grupeve të interesit.


Sa aktorë kanë marrë pjesë në konsultim?



Grafik C - Numri i aktorëve që kanë marrë pjesë në konsultim

Elementi i radhës për informacion lidhej me **numrin e aktorëve** që kanë marrë pjesë në konsultimin apo konsultimet publike të zhvilluara. Nga përgjigjet e bashkive rezulton se 15 nga 35 (43%) bashkitë e përgjigjura, kanë dhënë informacion mbi këtë kërkesë. Ndërkohë, 57% e tyre, pra 20 nuk i janë përgjigjur pyetjes së drejtuar.

Komentet e paraqitura (nëse janë marrë apo jo në shqyrtim)




Grafik D – Komentet e paraqitura gjatë procesit konsultues

TESTIMI NË PRAKTIKË I NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK DHE TË DREJTËS PËR INFORMIM


Në grafikun D janë paraqitur të gjetjet mbi dërgimin e komentet të paraqitura gjatë procesit konsultues pranë Qendrës Europiane. Nga përgjigjet e ardhura nga bashkitë rezulton se 8 nga 35 bashkitë ose 23% e tyre, kanë dërguar me postë diskutimet e zhvilluara gjatë konsultimeve publike. Ndërkohë, 77% e bashkive të tjera nuk dhanë informacion për komentet e ardhura gjatë procesit konsultues.

Informacion mbi buxhetimin gjinor



Grafik E – Informacion mbi buxhetimin gjinor

Elementi i buxhetimit gjinor u përfshi gjithashtu në kërkesën e Qendrës drejtuar bashkive. Në grafikun E janë pasqyruar të dhënat e gjeneruara në lidhje me informacionin mbi buxhetimin gjinor, përkatësisht ku dhe sa është përfshirë në programet buxhetore të bashkisë. Nga përgjigjet e ardhura rezulton se 14 bashki (40%), i janë përgjegjgur me informacion konkret kësaj kërkesë ndërsa 60% e tyre apo 21 nuk i janë përgjegjgur kësaj kërkesë.



Grafik F – Procesverbalet e konsultimeve

Kërkesa e fundit lidhej me mbajtjen e minutave të takimit gjatë sesioneve të konsultimit publik si dhe çdo informacion tjetër relevant në lidhje me këtë proces. Nga totali i përgjigjeve të ardhura, 28 bashki nuk kanë paraqitur asnjë informacion në lidhje me këtë kërkesë. Ndërkohë që 7 (20%) prej tyre kanë paraqitur informacion lidhur me minutat e konsultimeve, duke bashkëlidhur në dokumentet e dërguara, procesverbalët e mbajtur dhe foto të shkreputa gjatë zhvillimit të takimit.

GJETJET KRYESORE TË MONITORIMIT DHE REKOMANDIME

- Regjistri i konsultimit publik për qeverisjen vendore nuk është i përditësuar apo i plotë për të gjitha bashkitë.
- Në 28% të institucioneve publike në nivel vendor gjendet i publikuar plani vjetor i projekt-akteve për miratim. Në pjesën më të madhe të bashkive të tjera ky plan është i pa përditësuar apo i paaksesueshëm.
- 72% e bashkive nuk e kanë publikuar, përditësuar ose vendosur në akses raportin e transparencës së një viti më parë sipas detyrimeve të parashikuara në ligj.
- Pjesa më e madhe e faqeve zyrtare të bashkive janë lehtësisht të aksesueshme, për të cilën mund të evidentohet një aspekt pozitiv - 70% e tyre.
- Informacionet mbi konsultimet publike që do të kryhen janë të publikuara vetëm në 36% të bashkive. Ndërkohë, pjesa tjetër që zë më shumë se gjysmën e bashkive ky informacion mund të mos jetë publikuar, mund të mos aksesohet ose faqet janë të pa përditësuara.

- Sa i takon transparencës në lidhje me organizimin dhe funksionimin, vetëm 24 bashki e kanë të publikuar organigramën e institucionit, ndërsa pjesa tjetër nuk mund të aksesohet, nuk është publikuar ose është e papërditësuar. Ndërkohë, që 79% e të gjithë bashkive nuk kanë publikime të jetëshkrimeve të funksionarëve të lartë.
- Publikimi i listës së anëtarëve të Këshillit Bashkiak është bërë nga 42 bashki në vend dhe në rastet e tjera listat nuk janë të publikuara, nuk janë të aksesueshme ose nuk janë të përditësuara.
- Pjesa më e madhe e bashkive kanë publikuar vendimet e Këshillit Bashkiak, ku vetëm 15% e këtyre institucioneve nuk e kanë përmbushur këtë detyrim ligjor.
- Publikimi i financave vendore, duke përfshirë këtu shpenzimet dhe buxhetimet, është një problematikë që evidentohet në këtë monitorim, duke qenë se ky informacion nuk është i aksesueshëm online në 70% të bashkive.
- Të dhënat për koordinatorin për të drejtën për informim janë të publikuara në 81% të bashkive. Ndërkohë, ende sot 10 vjet pas miratimit të ligjit mungojnë në pjesën tjetër.
- Publikim i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve është bërë në mënyrë të plotë vetëm nga 33 bashki ose 54% e totalit të njësisve të qeverisjes vendore. Ndërsa pjesa tjetër nuk e kanë të publikuar, nuk e kanë përditësuar ose e kanë të paaksesueshëm. Sa i takon formatit të kërkesës për informacion më tepër se gjysma e bashkive e kanë publikuar këtë format.

- Në lidhje me testimin në praktikë të ligjeve në objekt të këtij raporti, 30 bashki kanë respektuar afatin ligjor, të parashikuar sipas ligjit për të drejtën e informimit duke kthyer përgjigje. Ndërsa, 5 bashki janë përgjigjur jashtë afatit. Vlen të evidentojmë se 26 bashki nuk i janë përgjigjur kërkesës për informacion dërguar nga Qendra Europiane dhe KAS.
- 7 bashki (20%) nga 35 që kanë kthyer përgjigje shkresore, kanë dhënë informacion lidhur me njoftimet që ju janë bërë organizatave apo grupeve të interesit lidhur me konsultimin publik.
- 14 nga 35 bashki që kanë kthyer përgjigje shkresore, kanë dhënë informacion mbi buxhetimin gjinor.
- Lidhur me procesverbalet e konsultimeve të kërkuara për efekt të këtij monitorimi, të cilat përbëjnë dokument zyrtar që duhet të shoqërojë konsultimin, vetëm 7 bashki ose 11% e atyre që u përgjigjën e ofruan këtë informacion.

Rekomandime

- Përditësimi dhe konsolidimi i regjistrit publik për konsulimin në nivel vendor është një domosdoshmëri, në përmbushje të detyrimeve ligjore që lindin për të gjithë njësitë e qeverisjes vendore në bazë të ligjit nr. 146/2014. Projekt-aktet e publikuara në këtë regjistër duhet të jenë të sinkronizuara me punën e të gjithë bashkive dhe publikimeve, që këto institucione bëjnë në faqet e tyre zyrtare. Regjistri i konsultimit publik përbën një mjet ligjor për njoftimin dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në procesin vendimmarrës, ndaj përditësimi i tij me të gjithë projekt-aktet vendore përbën një detyrim ligjor.
- Njësitë e qeverisjes vendore në rang vendi duhet ti kushtojnë një vëmendje të shtuar publikimit të planit vjetor të projekt-akteve me periudhat dhe afatet përkatëse. Publikimi i këtij plani, përpos përmbushjes së një detyrimi ligjor për të gjithë institucionet publike, bën të mundur planifikimin e pjesëmarrjes së grupeve të interesit në procesin konsultues. Njoftimi i afate gjithashtu bën që qytetarët të kenë mundësi reale për të dhënë kontributin e tyre në përmirësimin e këtyre projekt-akteve. Natyrisht, që afatet specifike në dispozicion për çdo projekt-akt duhet të variojnë në varësi të rëndësisë së aktit, sigurisht kjo në përmbushje të afateve ligjore.

- Vërehet një nevojë për përmirësimin e transparencës në lidhje me përmbushjen e detyrimit për publikimin e raportit vjetor të transparencës, të cilin vetëm 28% e të gjithë bashkive e kishin publikuar dhe vendosur në akses të publikut raportin e vitit paraardhës. Ky raport u shërben grupeve të interesit për të analizuar më mirë procesin e konsultimit dhe marrjen ose jo në shqyrtim të rekomandimeve për aktet në proces konsultimi.
- Njësitë e qeverisjes vendore në rang vendi duhet të tregohen më transparente sa i takon organizimit dhe funksionimit të tyre, si dhe publikimit të emrave dhe jetëshkrimeve të funksionarëve të lartë, që punojnë në këto institucione. Bërja publike e këtyre të dhënave mundëson informimin e publikut dhe grupeve të interesit për funksionarët e lartë, të cilët ushtrojnë pushtet publik në emër të tyre në nivel vendor, si dhe kanë mundësi të njihen me profilin dhe kualifikimet e tyre. Ky element krijon dhe mundësinë e monitorimit të funksionarëve nga grupet e interesit dhe qytetarët.
- Publikimi dhe transparenca në lidhje me financat vendore është vërejtur si problem sistematik i bashkive në shkallë vendi. Publikimi dhe bërja e aksesueshme për publikun e buxhetit, shpenzimeve faktike, si dhe e Programit Buxhetor Afatmesëm është jo vetëm një detyrim ligjor, por dhe kusht për një qeverisje të hapur ndaj qytetarëve. Këta të fundit duhet të vendosen patjetër në dijeni se ku shkojnë dhe si përdoren fondet publike të bashkisë së tyre.
- Gjatë monitorimit të funksionimit të ligjeve nr. 146/2014 dhe nr. 119/2014 është vërejtur se gati gjysma e bashkive në rang vendi nuk respektojnë

detyrimet dhe afatet e vendosura nga ligji për të drejtën e informimit, sa i takon kthimit të përgjigjeve, si dhe informacionit të përcjellë. Rezultatet e monitorimit na treguan se vetëm 35 nga 61 bashki iu përgjigjën, në afat ose tejkalim të tij, kërkesës për informacion dërguar nga Qendra Europiane dhe Fondacioni Konrand Adenauer. Megjithatë, nga këto institucione vetëm 7 nga i gjithë totali bënë të mundur përcjelljen e një informacioni të plotë. Një situatë jo shumë pozitive u has dhe me regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, i cili mungonte në 46% të bashkive. Këto rezultate tregojnë nevojën për rritje të kapaciteteve të koordinatorëve për të drejtën për informim pranë bashkive, të cilët duhet të jenë të përditësuar me standardet evropiane të qeverisjes së hapur dhe respektimit të të drejtave themelore sikurse është dhe e drejta për informim.

- Si rekomandim i fundit në përmbyllje të këtij raporti do të ishte krijimi i një mekanizmi ligjor detyrues dhe sanksionues, i cili do të adresonte të gjitha shkeljet që i bëhen ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, me qëllim që në rast mos respektimi të detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj të mos mbeten në diskrecionin e funksionarëve të institucioneve në nivel vendor.

Shtojca 1

Bashkia	Plani vjetor i projekt-akteve	Raporti i transparencës së një viti më parë	Faqja e lehtë në akses	Informacione mbi konsultimin dhe informimin publik	Afatet për rekomandime në dokumentet e publikuara	Të dhëna mbi koordinatorin	Kontaktet e koordinatorit, adresa nr. tel	Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve	Formati i ankesave dhe kërkesave	Struktura organizative	Cv e funksionarëve të lartë	Lista e anëtarëve të Këshillit	Vendimet e Këshillit Bashkiak	Raportet dhe financat
Belsh	I publikuar	I publikuar	Lehtësisht e aksesueshme	Të publikuara	Nuk kishte afate për rekomandimet	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar e ndarë sipas punës	Të publikuara	Të publikuara
Berat	Nuk është i publikuar	Nuk është i publikuar	Lehtësisht e aksesueshme	Të publikuara	Nuk janë publikuar afate për rekomandimet	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Nuk është i publikuar	E publikuar	Nuk janë te publikuara	E publikuar, e ndarë sipas detyrave	Të publikuara	Të publikuara
Bulqizë	I publikuar	Nuk është i publikuar	Lehtësisht e aksesueshme	Të publikuara	Nuk janë publikuar afate	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuar	E publikuar sipas detyrave	Të publikuara	Të publikuara
Cërrik	I publikuar	Nuk është i publikuar	Lehtësisht e aksesueshme	Të publikuara	Nuk janë të publikuara me afate	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Nuk është i publikuar	Nuk është e përpunuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Të publikuara	Të publikuar
Delvinë	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Nuk është i publikuar (vetëm kriteret)	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk sesohet	Faqja nuk aksesohet	Të publikuara, e fundit 2023	Faqja nuk aksesohet
Devoll	Nuk është i publikuar	Është i publikuar	Lehtësisht e aksesueshme	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Nuk është i publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Të publikuara	Të publikuara
Dibër	Nuk është i publikuar	I publikuar	Faqja nuk është lehtësisht e aksesueshme	Të publikuar	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	E publikuar	Nuk është e publikuar	E publikuar	Të publikuar	Nuk është i publikuar
Divjakë	Nuk është i publikuar	Nuk është i publikuar	Faqja nuk është lehtësisht e aksesueshme	Të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk është e publikuar	Të publikuara	Raportet të pa rifreskuara
Dropull	Nuk është i publikuar	Nuk është i publikuar	Lehtësisht e aksesueshme	Të pa rifreskuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Nuk është e publikuar	Të publikuara	Nuk është i publikuar
Durrës	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Faqja nuk është lehtësisht e aksesueshme	Të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Të publikuara	Të publikuara
Elbasan	I publikuar	I publikuar	Faqja nuk është lehtësisht e aksesueshme	E pa rifreskuar	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	E pa rifreskuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Të publikuara	Të publikuara
Fier	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Lehtësisht e aksesueshme	E pa rifreskuar	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Të publikuara	Të publikuara

Finiq	Nuk është i rifreskuar	Nuk është i publikuar	Lehtësisht e aksesueshme	E pa rifreskuar	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Të publikuara	Nuk hapen
Fushë- Arrëz	Nuk është i rifreskuar	Nuk është i publikuar	Lehtësisht e aksesueshme	Nuk janë të publikuara	Nuk janë të publikuara	Nuk është e publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk është i publikuar	Nuk është i publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Janë të publikuara	Nuk janë të publikuara
Gjirokastrë	Nuk është i publikuar	Nuk është i rifreskuar	Lehtësisht e aksesueshme	Nuk është i rifreskuar	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	Nuk janë të rifreskuara (e fundit e publikuar në vitin 2018)	Të publikuara	Nuk janë të publikuara
Gramsh	Nuk është i publikuar	Nuk është i rifreskuar	Nuk ka një rubrike mbi konsultimet publike	Nuk është i publikuar	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk është e publikuar	E publikuar	Të publikuara	Nuk janë të publikuara
Has	Nuk është i publikuar	Është i publikuar	Lehtësisht e aksesueshme	Nuk është i rifreskuar	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Nuk është i rifreskuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk është e rifreskuar	Të publikuara	Nuk janë të publikuara
Himarë	Është i publikuar	Nuk është i publikuar	Faqja nuk është lehtësisht e aksesueshme	Janë të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Të publikuara	Nuk janë të publikuara
Kamëz	Nuk është i publikuar	Nuk është i publikuar	Lehtësisht e aksesueshme	Nuk është i publikuar	Nuk është i publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Të pa rifreskuara (I fundit, 15 shkurt 2023)	Nuk janë të publikuara
Kavajë	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Faqja është e strukturuar, por bosh	Faqja është bosh	Faqja është bosh	Nuk është e publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Faqja është bosh	Vetëm një vendim i datës 14.04.2023 është i afishuar. Tek vendime.al, të fundit janë të regjistruara në 2022	Faqja është bosh
Këlcyrë	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Faqja është e strukturuar, por bosh	Faqja është bosh	Faqja është bosh	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Nuk është i publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Faqja është bosh	Nuk janë të përditësuara , tek vendime.al i fundit është i regjistruar në vitin 2020	Faqja është bosh
Klos	I publikuar	Nuk është i publikuar	Faqja e lehtë në akses	Nuk janë të publikuara	Nuk është i publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Të publikuara	Janë të publikuara
Kolonjë	I publikuar	Nuk janë të publikuara	Faqja e lehtë në akses	Janë të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Janë të publikuara	Janë të publikuara

Konispol	Nuk hapet	Nuk hapet	Faqja e lehtë në akses	Nuk janë të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Janë të publikuara	Nuk janë të publikuara
Korçë	Nuk është i publikuar	Nuk është i publikuar	Faqja nuk është lehtësisht e aksesueshme	Te publikuara, por jo te rifreskuara	Nuk janë të publikuara	Nuk është e publikuar	Nuk është e publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Nuk është e publikuar	Janë të publikuara	Nuk janë të publikuara
Krujë	Nuk është i publikuar	Nuk është i publikuar	Faqja e lehtë në akses	Nuk është i publikuar	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Janë të publikuara	E publikuar, por jo e përditësuar
Kuçovë	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Janë të publikuara	Faqja nuk hapet
Kukës	Të dhëna të pa rifreskuara	Nuk është i publikuar	Faqja e lehtë në akses	Të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Janë të publikuara	Nuk janë të publikuara
Kurbini	Nuk është i publikuar	Nuk është i publikuar	Faqja nuk është lehtësisht e aksesueshme	Të publikuara, por jo te rifreskuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Janë të publikuara	Nuk janë të publikuara
Lezhë	Pjesërisht i publikuar	Nuk është i publikuar	Faqja e lehtë në akses	Të publikuara, por jo te përditësuar	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	Nuk është e publikuar	Janë të publikuara	Nuk janë të publikuara
Libohovë	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Faqja e lehtë në akses	Faqja është bosh	S'ka informacion	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Nuk gjenden	E papërditësuar
Librazhd	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Të pa rifreskuara që prej 2022	Faqja nuk hapet
Lushnjë	I publikuar	Nuk është i përditësuar	Faqja e lehtë në akses	Të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Janë të publikuara	E papërditësuar
Malësi e Madhe	Publikuar, por jo përditësuar që nga viti 2021	Nuk është i përditësuar	Faqja e lehtë në akses	Të publikuara	Të publikuara	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Publikuar	E pa përditësuar që nga viti 2020	Janë publikuar që në vitin 2019	Nuk është e përditësuar	Janë të publikuara	Janë të publikuara
Maliq	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Faqja e lehtë në akses	Faqja është bosh	Faqja është bosh	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk klikohet	Faqja nuk klikohet	Të publikuara	Janë të publikuara	Faqja nuk klikohet
Mallakastër	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Faqja e lehtë në akses	Faqja është bosh	Faqja është bosh	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Publikuar	E publikuar	Të publikuara	Të publikuara	Janë të publikuara	Nuk ka informacion
Mat	Të publikuara	Nuk janë të publikuara	Faqja e lehtë në akses	Të pa rifreskuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	Nuk janë të publikuar	Janë të publikuara	Të publikuara
Memaliaj	Të publikuara	Nuk janë të publikuara	Faqja e lehtë në akses	Të publikuara	Të publikuara	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Të publikuara	Janë të publikuara	Të papërditësuar
Mirditë	Të publikuara	Nuk janë të publikuara	Faqja e lehtë në akses	Të publikuara	Afatet nuk janë të publikuara, por janë të publikuara kontaktet ku mund të japin rekomandime.	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Të publikuara	Janë të publikuara	Të publikuara

Patos	Të publikuara	Nuk janë të përditësuara	Faqja e lehtë në akses	Të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Të publikuara	Janë të publikuara	Të publikuara
Peqin	Nuk janë të publikuara	Nuk janë të publikuara	Faqja e lehtë në akses	Të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Të publikuara	Janë të publikuara	Të publikuara
Përmet	Nuk janë të publikuara	Nuk janë të publikuara	Faqja e lehtë në akses	Nuk janë të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	Është publikuar	Nuk janë të publikuara	Të publikuara	Janë të publikuara	Nuk janë të rifreskuara
Pogradec	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Të publikuara tek vendime.al	Faqja nuk hapet
Polican	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Të publikuara tek vendime.al	Faqja nuk hapet
Prrenjas	Të publikuara	Nuk është i publikuar	Faqja e lehtë në akses	Të publikuara	Të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Të publikuara	Të publikuara, por jo të rifreskuara, 26.07.2023 i fundit	Të publikuara
Pukë	Nuk janë të publikuara	Nuk është i publikuar	Faqja e lehtë në akses	Nuk është e përditësuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	Nuk është i publikuar	E publikuar	Jo për të gjithë anëtarët	Të publikuara	Të publikuara, por jo të përditësuara	Nuk janë të përditësuara
Pustec	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Faqja e lehtë në akses	Nuk është e përditësuar	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar (jep vetëm çfarë duhet te ketë me pika)	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Të publikuara	Të publikuara	Nuk janë të publikuara
Roskovec	Nuk janë të publikuara	Nuk është i publikuar	Faqja nuk është lehtësisht e aksesueshme	Të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Nuk është e publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	Nuk është e publikuar	Të publikuara	Të publikuara	Të publikuara	Nuk janë të publikuara
Rrogozhinë	Të publikuara	Nuk është i publikuar	Faqja e lehtë në akses	Nuk ka informacion	Kjo rubrikë është bosh	Publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	Nuk është i publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	Të publikuara	Të publikuara	Nuk janë të publikuara
Sarandë	Të publikuara	Nuk është i publikuar	Faqja e lehtë në akses	Të publikuara	Të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	Të publikuara	Të publikuara	Buxheti është i publikuar, treguesit financiarë janë të publikuar, por raportet nuk janë të rifreskuara
Selenicë	I publikuar	Nuk është i publikuar	Faqja e lehtë në akses	Të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Nuk është i përditësuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Të publikuara	Të publikuara	Nuk janë të përditësuara
Shijak	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk aksesohet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Faqja nuk hapet	Të publikura, por jo të përditësuara	Faqja nuk hapet

Shkodër	Nuk është i publikuar	E publikuar	Faqja nuk është lehtësisht e aksesueshme	Nuk janë të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Të publikuara	Nuk janë të publikuara
Skrapar	Nuk është i përditësuar	Nuk është i publikuar	Faqja e lehtë në akses	Te publikuara	Nuk janë te publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	E publikuar	Janë të publikuara	E publikuar	Të publikuara	Nuk janë të përditesuara
Tepelenë	Nuk është i përditësuar	Nuk është i publikuar	Faqja e lehtë në akses	Nuk janë të publikuara	Nuk janë të publikuara	Nuk është e publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk është i publikuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	E publikuar	Të publikuara	Të publikuara
Tiranë	Nuk është i publikuar	Nuk është i rifreskuar	Faqja e lehtë në akses	Nuk janë të rifreskuara	Nuk janë të publikuara	Nuk është e përditësuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	Publikuar	E publikuar	Nuk janë te publikuara	Nuk është e publikuar	Të publikuara	Të publikuara
Tropojë	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Faqja e lehtë në akses	Nuk ka informacion	Nuk ka informacion	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë te publikuara	E publikuar	Të publikuara	Nuk ka informacion
Urë Vajgurore	I publikuar	Nuk është i publikuar	Faqja nuk është lehtësisht e aksesueshme	Nuk janë të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Nuk është e publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	E publikuar	Vetëm cv e kryetares	Nuk është e publikuar	Nuk del informacion	Nuk janë të publikuara
Vau Dejës	I pa rifreskuar, i fundit i publikuar ne 2021	Nuk është i publikuar	Faqja e lehtë në akses	Nuk janë të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Të publikuar	Të publikuar	Nuk janë të publikuara
Vlorë	I pa rifreskuar	I pa rifreskuar	Faqja e lehtë në akses	Të publikuara	Nuk janë të publikuara	Publikuar	Publikuar	Nuk është i publikuar	Nuk është i publikuar	Nuk është e publikuar	Nuk janë të publikuara	Nuk janë të publikuara	Të publikuar	Nuk janë të publikuara
Vorë	Faqja është bosh	Faqja është bosh	Faqja e lehtë në akses	Faqja është bosh	Faqja është bosh	Publikuar	Publikuar	Publikuar	Publikuar	E publikuar	Nuk janë të publikuara	Të publikuar	Të publikuar	Janë të pa rifreskuara

BIBLIOGRAFI

Akte normative Kombëtare

Ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”

Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”

Materiale nga interneti

OECD Library - <https://www.oecd-ilibrary.org/deliver/0fdc1657-en.pdf?itemId=/content/publication/0fdc1657-en&mimeType=pdf>

Council of Europe, (2019) CODE OF GOOD PRACTICE FOR CIVIL PARTICIPATION IN THE DECISION-MAKING PROCESS [<https://rm.coe.int/code-of-good-practice-civil-participation-revised-301019-en/168098b0e2>]

OECD, Background Document on Public Consultation [<https://www.oecd.org/mena/governance/36785341.pdf>]